

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Konflikt në Durrës/ Shefi i Policisë së Krujës përplaslet fizikisht me pronarin e ish-hotelit “Mira Mare”: Nuk e kam kërcënuar, më shau, e shava
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/konflikt-ne-durres-shefi-i-policise-se-krujes-perplaslet-fizikisht-m-i515997
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 13:26:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 13:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	73f6bdb0d37c53c37ccf8e06fdb0575018a757326dc6e3c8d142d63202939aee
TEKSTI	74cf84b4e9127b3d3199d57fb7772a8ca29ceb16b4130f565387baa35d39c97d
PAMJA	e2330a158a2aa06402fdb547eb96dd48d1b4c911fdebdddee3dfbe6c91f9fd9c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d85a554a349f4bc83b5c8b051a2cdc63ba26eff26e27eb6992ac5f0dcc0a9f92
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3a6c0ee943067392b175e06ac07a7b9996bbd474953cea4f063ab0e555023da
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d85a554a349f4bc83b5c8b051a2cdc63ba26eff26e27eb6992ac5f0dcc0a9f92>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

13 MINUTA ME PARE

Konflikt në Durrës/ Shefi i Policisë së Krujës përplasht fizikisht me pronarin e ish-hotelit “Mira Mare”: Nuk e kam kërcënuar, më shau, e shava

16 ORE ME PARE

Tensione dhe braktisje salla në OKB/ Netanyahu sulmon Turqinë e Katarin, paralajmëron rënien e regjimit iranian. Mamdani: Përdori fjalimin e tij për të përsëritur gënjeshtër të pabazë

20 ORE ME PARE

Dita e 117-të e protestës/ Qytetarët zbrisin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

23 ORE ME PARE

Vlora Hyseni sulmon Klodiana Lalën para GJKKO-së, gazetarja: Shantazh. AGSH: Të tërheqë deklaratat (REAGIMET)

LIVE UPDATES

Konflikt në Durrës/ Shefi i Policisë së Krujës përplasht fizikisht me pronarin e ish-hotelit “Mira Mare”: Nuk e kam kërcënuar, më shau, e shava

• Një situatë e paprecedentë ka ndodhur një muaj më parë në qytetin e Durrësit, ku shefi i Komisarariatit Krujë, Elton Shahini dhe ish-shef i Komisarariatit Nr. 1 në Tiranë janë përfshirë në një konflikt me një drejtues automjeti. • Bazuar në pamjet e bëra publike, Shahini shihet duke lëvizur me motor dhe në një moment shan drejtuesin e një automjeti. • Pas këtij ofendimi, situata përshkallëzohet dhe drejtuesi i mjetit zbrit nga makina dhe i drejtohet Shahinit, duke e goditur me shpullë. • Personi që godet me shuplakë Shahinin është Arjan Xheka, pronar i ish-hotelit “Mira Mare”, një prej hoteleve që u shemb në tërmetin e 26 nëntorit 2019 në Durrës. • Përplasja mes dy personave nuk ka çuar në nisjen e një procedimi penal. • Sipas të dhënave, konflikti është konsideruar si një përplasje banale mes dy personave dhe më pas është mbyllur mes palëve. • Pas kësaj ka reaguar edhe Shefi i Komisarariatit të Krujës, i cili ka treguar se në momentin e ngjarjes ishte jashtë orarit të punës në fundjavë dhe po udhëtonte me motor drejt plazhit. • Sipas tij, drejtuesi i një automjeti, i cili shihet edhe në video ka kryer manovra të rrezikshme dhe e ka goditur me pasqyrën e makinës. • Sipas shefit të Komisarariatit të Krujës, mes tij dhe drejtuesit të automjetit ka pasur më pas një përplasje verbale. • Ai ka mohuar se ka kërcënuar apo ka ushtruar dhunë fizike ndaj personit tjetër të përfshirë në incident. • Shahini thekson gjithashtu se, megjithëse ishte civil dhe jashtë orarit zyrtar të punës, nuk e përdori autoritetin e tij si drejtues i komisarariatit të policisë së Krujës gjatë konfliktit.

3 artikuj për këtë temë.

41 MINUTA ME PARE

“Më goditi me pasqyrë”/ Flet shefi i Komisarariatit të Krujës pas publikimit të videos: Nuk e kam kërcënuar, më shau, e shava



Elton Shahini

TIRANË. Shefi i Komisarariatit të Policisë së Krujës, Elton Shahini, ka reaguar lidhur me incidentin ku u nënfehi në ditën e

editoriale

Eriseld Zeneli

Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën

Irena Beqiraj

Kostot e jetesës edhe lajmi se ekonomia po ecën mirë

Në vëmendje

AKTUALITET 25 SHTATOR 2026, 12:08

“Të q*fshe motrën”/ Shefi i Policisë së Krujës shan qytetarin, ai zbrit nga makina dhe e qëllon me shpullë

Shahini ka dhënë versionin e tij për rrethanat dhe dinamikën e ngjarjes.

Shefi i Komisarariatit të Krujës ka treguar se në momentin e ngjarjes ishte jashtë orarit të punës në fundjavë dhe po udhëtonte me motor drejt plazhit. Sipas tij, drejtuesi i një automjeti, i cili shihet edhe në video ka kryer manovra të rrezikshme dhe e ka goditur me pasqyrën e makinës.

JU SUGJEROJME



["Të q*fsha motrën"/ Shefi i Policisë së Krujës shan qytetarin, ai zbret nga makina dhe e qëllon me shpullë \(VIDEO\)](#)

25 Shtator, 12:23



"Ka qenë fundjavë, ditë pushimi zyrtare. Kam qenë duke shkuar në plazh, isha duke ecur me motor, isha në punën time. Në ato momente, shoferi që duket në video ka qenë duke ecur në mënyrë të papërgjegjshme në rrugë dhe bënte manovra të rrezikshme. Kur më ka kaluar pranë, më ka goditur me pasqyrë", tha Shahini.

Sipas shefit të Komisarariatit të Krujës, mes tij dhe drejtuesit të automjetit ka pasur më pas një përplasje verbale. Ai mohon se ka kërcënuar apo ka ushtruar dhunë fizike ndaj personit tjetër të përfshirë në incident. Shahini thekson gjithashtu se, megjithëse ishte civil dhe jashtë orarit zyrtar të punës, nuk e përdori autoritetin e tij si drejtues i komisarariatit të policisë së Krujës gjatë konfliktit.

"Më shau, e shava. Nuk e kam kërcënuar dhe as kam ushtruar dhunë fizike. Pavarësisht dhunës fizike dhe fyerjeve ndaj meje, në asnjë moment nuk kam përdorur autoritetin tim zyrtar, nuk kam kërcënuar me postin që mbaj dhe nuk jam përgjigjur me dhunë fizike", tha ndër të tjera shefi i Komisarariatit të Krujës./Dosja.al

1 ORE ME PARE

Detaje nga sherri në Durrës, pronari i hotelit që u shemb gjatë tërmetit goditi me shpulla shefin e komisarariatit



pamjet nga sherri

DURRËS- Detaje të reja janë zbardhur lidhur me konfliktin e ndodhur në rrugë të Durrësit mes një qytetari dhe Elton Shahinit, shef i Komisarariatit Krujë dhe ish-shef i Komisarariatit Nr. 1 në Tiranë.

Sipas informacioneve, personi që shfaqet në video duke goditur me shuplakë Shahinin është Arjan Xheka, pronar i ish-hotelit "Mira Mare", një prej hoteleve që u shemb në tërmetin e 26 nëntorit 2019 në Durrës. Përplasja mes dy personave nuk ka çuar në nisjen e një procedimi penal.

JU SUGJEROJME



["Të q*fsha motrën"/ Shefi i Policisë së Krujës shan qytetarin, ai zbret nga makina dhe e qëllon me shpullë \(VIDEO\)](#)

25 Shtator, 12:23



(VIDEO)

POLITIKE 25 SHTATOR 2026, 10:13

BIRN: Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë njësh në mbrojtje të Ergys Agasit



AKTUALITET 25 SHTATOR 2026, 07:44

"O Kriminel, o mafia"/ Shqiptarët qëllojnë me vezë Edi Ramën në SHBA: E gjithë Shqipëria ty të urren

më të klikuarat

"Të q*fsha motrën"/ Shefi i Policisë së Krujës shan qytetarin, ai zbret nga makina dhe e qëllon me shpullë (VIDEO)



"O Kriminel, o mafia"/ Shqiptarët qëllojnë me vezë Edi Ramën në SHBA: E gjithë Shqipëria ty të urren

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, kryeministri Rama mban sot fjalimin e tij në hapje të debatit

Plagosja e të riut në Lezhë/ Pagesa e riparimit të makinës bëhet "mollë sherri", kamerat e sigurisë zbardhin konfliktin! Autorët u larguan me makinë, babë e bir në kërkim (EMRAT)

insights

Rezarta Gagani

Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Edvin Krasniqi

Personi që u godit, Elton Shahini nuk ka bërë denoncim në polici dhe për këtë arsye nuk është regjistruar një procedim lidhur me ngjarjen. Sipas të dhënave, konflikti është konsideruar si një përplasje banale mes dy personave dhe më pas është mbyllur mes palëve./Dosja.al

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Moti

Powered by  tomorrow


3 ORE ME PARE

"Të q*fsha motrën"/ Shefi i Policisë së Krujës shan qytetarin, ai zbret nga makina dhe e qëllon me shpullë (VIDEO)



pamjet

DURRËS- Një situatë e paprecedentë raportohet të ketë ndodhur një muaj më parë në qytetin e Durrësit, ku shefi i Komisarariatit Krujë, Elton Shahini dhe ish-shef i Komisarariatit Nr. 1 në Tiranë është përfshirë në një konflikt me një drejtues automjeti.




Sipas pamjeve, Shahini shihet duke lëvizur me motor dhe në një moment shan drejtuesin e një automjeti, duke i thënë: Të q*fsha motrën. Pas këtij ofendimi, situata përshkallëzohet dhe drejtuesi i mjetit zbret nga makina dhe i drejtohet Shahinit, duke e goditur me shpullë.

Drejtuesi i automjetit i drejtohet Shahinit edhe me fjalët: "Kë shan nga r*pt ti?!". Megjithatë detajet e ngjarjes janë ende të paqarta, por mbeten për tu sqaruar shkaqet dhe rrethanat që çuan në përshkallëzimin e konfliktit./Dosja.al

Sondazh

Poll



"O Kriminel, o mafia"/ Shqiptarët qëllojnë me vezë Edi Ramën në SHBA: E gjithë Shqipëria ty të urren

"O Kriminel, o mafia"/ Shqiptarët qëllojnë me vezë Edi Ramën në SHBA: E gjithë Shqipëria ty të urren

Mbyllen fjalimet para Kryeministrit, qytetarët marshojnë në rrugët e kryeqytetit...

Aktivisti Lika për Vlora Hysenin: Nuk duhej të futej në SPAK, duhet të jetë në burg

Aktivisti Arben Kola thirrje shqiptarëve në SHBA: Priteni Ramën me vezë para OKB-së...

[Shiko video te tjera](#)

[KTHEHU NE KRYE](#)

Dosja.al është një iniciativë gazetare e rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [\[email protected\]](#)

[f](#) [ig](#) [yt](#) [d](#)

[KONTAKT](#) [PRIVACY POLICY](#) [COOKIES](#)

MEMBERSHIP SICA [Mediodesk](#)

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtor: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:
Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.